



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

---

**Kom.Dh.Sh.II.nr.842/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË** - Dhoma e shkallës së dytë, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Saranda Bogaj-Sheremeti, kryetarë e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit-kundër padituri N.T.P “Y...”, me seli në Prishtinë, të cilën përfaqëson sipas autorizimit M.H, kundër të paditurës-kundër paditëses “Pro Credit Bank” A.S., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Kujtim Kërveshi, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti pasurim i pa bazë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.43/19, të datës 12.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.11.2022, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës-kundër paditëses “ProCredit Bank” A.S, me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** Aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.43/19, të datës 12.03.2021.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në pikën të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit-kundër paditurit N.T.P “Y...”, me seli në Prishtinë, ashtu që në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është vërtetuar se neni 3 par.2 nën-paragrafëve (a), (b) dhe (c) të kontratës së Kredisë për biznes me nr. .... e dt.16.12.2015, dhe neni 6 me titull “Parapagimi i Kredisë” i paraparë në kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.17.06.2016 si dhe në Kontratën për Biznes me nr. .... e dt.24.03.2017, lidhur me kthimin e parakohshme të kredisë t’ia paguaj prej 50% të interesit që është dashur të paguaj deri ne maturin e kontratave për Kredi, është NUL dhe nuk prodhon efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura/kundër paditësja “Pro Credit Bank” A.S., me seli në Prishtinë, që paditësit/kundër paditurit N.T.P “Y....”, me seli në Prishtinë, që në emër të fitimit pa bazë t’ia paguaj shumën prej 9.310.34

(nëntëmijë e treqind e dhjetë euro e tridhjetë e katër cent), të inkasuar me rastin e parapagimit të kredive sipas kontratës së Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.17.06.2016 dhe në kontratën Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.24.03.2017, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 06.04.2018, të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Tutje në pikën III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kundërpadia e të paditurës/kundër paditëses, që paditësi/kundër padituri t'ia kompensoi dëmin material dhe fitimin e humbur, për shkak të parapagimit të kredive sipas kontratës së Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.16.12.2015, kontratës së Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.17.06.2016 dhe kontratës së Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.24.03.2017, ndërsa në pikën IV të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është detyruar që e paditura t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestime në shumën e përgjithshme prej 1.229.20 euro, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura – kundër paditëse Pro Credit Bank” A.S., me seli në Prishtinë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, ankesën e të paditurës-kundër paditëses ta aprovojë, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike, I.EK.nr.43/19, të datës 12.03.2021, ta ndryshojë, ashtu që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit/kundër të paditurit “Y....”, ta aprovojë si të bazuar kundërpadinë e të paditurës/kundër paditëses “Pro Credit Bank” ose që i njëjti aktgjykim të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse/kundër paditura me propozim që ankesën e palës së paditur – kundër paditëse Pro Credit Bank” A.S., me seli në Prishtinë ta refuzojë si të pabazuar ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike, EK.nr.43/15, të datës 12.03.2021, ta vërtetojë në tërësi si të bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi-kundër padituri N.T.P “Y....”, me seli në Prishtinë me datën 30.01.2019 ka parashtruar pranë gjykatës së shkallës së parë padi kundër të paditurit paditurës-kundër paditëses “Pro Credit Bank” A.S., me seli në Prishtinë, për shkak të pasurimit të pa bazë, me të cilën i ka kërkuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar, të konstatojë se dispozitat e kontestuara të Kontratave të Kredive janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 1058, par 3 i LMD-së si dhe të njëjtat t'i shpallë të pavlefshme, të detyrohet i Padituri që t'ia kthejë pasurinë e fituar në mënyre të pabazë paditësit në shumën prej 9.310.34€ me anë të pasurit të duke përfshirë dhe kamatën ligjore 8% në vit prej datës së inkasimit e deri në pagesën definitive, si dhe të detyrohet i Padituri t'ia kompensojë Paditësit të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të propozuar në kërkesëpadi.

E paditura-kundër paditësi “Pro Credit Bank” ka paraqitur Kundër padi, me propozim që gjykata ta refuzoj në tërësi padinë e paditës-kundër të paditurit në formën dhe mënyrën se si e ka përcaktuar atë si e pa bazuar, të vërtetoj se i padituri – kundër paditësi ka pësuar dëm material dhe fitim të humbur, të detyroj paditësin- kundër të paditurin që të paditurit – kundër paditësit t’ia shpërblej shumën e dëmit dhe fitimit të humbur është përcaktuar në pikën II të këtij dispozitivit (të dëmit material dhe fitimit të humbur), si dhe të detyrohet paditësi – kundër i padituri që të paditurit – kundër paditësit t’ia kompensojë dhe shpenzimet procedurale për aq sa do të krijohen sipas tarifës së OAK-së dhe shpenzimeve tjera të aprovuara nga gjykata.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit – kundër paditurit si të bazuar pasi ka vërtetuar që se neni 3 par 2, nën-paragrafëve (a), (b) dhe (c) të kontratës së Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.16.12.2015, dhe neni 6 me titull “Parapagimi i Kredisë” i paraparë me kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.17.06.2016 si dhe në kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.24.03.2017 lidhur me kthimin e parakohshme të kredisë t’ia paguaj prej 50% të interesit që është dashur ta paguaj lidhur ne maturimin e kontratave për Kredi është nul, dhe si e tillë nuk prodhon efekt juridik.

Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim së paditësi-kundër padituri i ka bërë pagesë palës se paditur-kundër paditësit pa pasur borxh shumën prej 9.310.34(nëntëmijë e treqind e dhjetë euro e tridhjetë e katër cent), të inkasuara me rastin e parapagimit të kredive sipas kontratave të Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.16.12.2015, kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.17.06.2016 dhe në kontratën Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.24.03.2017 dhe mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të atakuar.

Meqenëse mjetet financiare të paditësit kanë kaluar nga paditësi-kundër padituri tek i padituri-kundër paditësi pa pasur borxh, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se pagesa ka qenë pa bazë juridike, andaj obligohet e paditura-kundër paditësi që paditësit-kundër paditurit t’ia ktheje paditësit – kundër paditurit shumën prej 9.310.34(nëntëmijë e treqind e dhjetë euro e tridhjetë e katër cent).

Ndërsa gjykata e shkallës së parë e ke refuzuar si të pabazuar kundërpadinë e të paditurës/kundër paditëses që paditësit/kundër paditurit t’ia kompensoje dëmin material dhe fitimin e humbur për shkak të parapagimit të kredive sipas kontratës së kredisë për biznes me nr. .... të datës 16.12.2015, kontratës së kredisë për biznes me nr. .... e datës 17.06.2016 dhe kontratës së kredisë për biznes me nr. .... të datës 24.03.2017. Prandaj, gjykata e shkallës së parë mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 1068 par.4 dhe par.3, 103, 91, 86,87 të LMD-së, si dhe në dispozitat e nenit 366 par.1 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të atakuar.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta

materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale vlerëson së gjykata e shkallës së parën drejte ka zbatuar të drejtën materiale sepse me dispozitën e nenit 1068 par.4 të LMD-së përcaktohet se *“në rastin e kthimit të kredisë para afatit të caktuar, banka nuk mund ta kalkulojë kamatën për kohën prej ditës së kthimit të kredisë deri në ditën kur sipas kontratës është dashur të kthehet, e paditura nuk ka pasur të drejtë që ta kalkulojë kamatën për kohën nga data e kthimit të kredisë deri në kohën kur sipas marrveshjes paditesi është dashur të kthejë kredin sepse kjo dispozitë është e natyres imperative e cila e ndalon sjelljen në raport juridike në kundërshtim me normat konkrete juridike, meqenese rregullat e percaktuara me dispozitat e e cekura janë të natyres imperative banka gjatë veprimtari të tyre ka për obligim që kushtet e kredise ti percaktoje në përputhje me dispozitat perkatese. Po ashtu në paragrafin 4 të nenit 1068 të Ligjit të Mardhenieve të Detyrimeve përcaktohet se *“në të dy rastet shfrytëzuesi i kredisë ka për detyrë ta kompensojë dëmin në qoftë se e ka pësuar dhënësi i kredisë”*, në këtë rast rezulton se paditesi huamarresi ka obligim ta kompensojë dëmin real në qoftëse ka pësuar banka për shkak të kthimit të kredisë para afatit të kontraktuar, në këte rast banka nuk ka pësuar asnje lloje dëmi ku nga ekspertiza financiare e datës 09.03.2020 dhe plotesimeve të ekspertizes së datës 28.07.2020 dhe datës 24.12.2020 ku është vertetuar se paditesi/ kunder e paditura në cilesin e kredimarrësit me rastin e mbylljes se parakohshme të kredive dhe overdraftit si dhe të gjitha obligimeve ndaj të paditues kundër paditëses nuk i ka shkaktuar asnje dëm.*

Prandaj, Gjykata Komerciale - dhomat e shkallës së dyte vlerëson se me dispozitat e nenit 3 paragrafi 2 nën paragrafëve (a), (b), dhe (c) të kontratës së Kredisë për Biznes me nr. .... të datës 16.12.2015 neni 6 me titullin *“Parapagimi i kredisë”* e paraparë në kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e datës 17.06.2016 dhe në kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e datës 24.03.2017 janë në kundërshtim me normat imperative dhe nuk prodhon efekt juidik dhe rrjedhimisht e paditura/kundërpaditesja nuk ka mund ti aplikojë. Andaj konfom nenit 103 të LMD-së në të cilën përcaktohet se *“Kontrata që është në kundërshtim me parimet e percaktuara me kushtetutë të rreguilimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk pasjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër”*, e konsideron dispozitë kontraktuese NULE, sipas nenit 91 të LMD-së nuliteti i një dispozitë kontraktuese nuk mund të këtë pasojë edhe nulitetin e vet kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndroje pa dispozitën nule. Andaj, Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë vlerëojn se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka vlerësuar se kontrata ndërmjet palëve kontraktuese pa këtë dispozitë ka mbetur në fuqi.

Kjo gjykatë vlerëson së dispozita e nenit 194 të LMD-së, e cila përcakton se *“secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri”*. Në rastin konkret, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se e paditura-kundër paditësja ka paguar shumë të parave sipas kontratave të Kredisë për Biznes me nr.10097004 e dt.16.12.2015, kontratën e Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.17.06.2016 dhe në kontratën Kredisë për Biznes me nr. .... e dt.24.03.2017 në shumë të përgjithshme 9.310.34€. Prandaj, kjo gjykate vlerëson së i padituri është

pasuruar pa bazë juridike në shumën prej 9.310.34€, dhe me këtë raste ekziston obligimi i të paditurës që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 9.310.34€.

Kjo gjykatë vlerëson po ashtu se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar kërkesëpadine e të paditurës/kundërpaditëses si të pabazuar ngase nga provat nga shkresat e lëndës dhe duke u bazuar në ekspertizën financiare me të cilën rezultoi se paditësi/ kundërpadituri nuk i ka shkaktuar dëm të paditurës/kundërpaditëses me rastin e parapagimit të kredisë.

Meqenëse mjetet e paditësit në shumën prej 9.310.34(nëntë mijë e treqind e dhjetë euro e tridhjetë e katër cent) kanë kaluar tek i padituri pa bazë ligjore, respektivisht pa pasur borxh, i padituri-kundër paditësi është i detyruar që t'ia kthejë paditësit-kundër paditurit shumën 9.310.34(nëntë mijë e treqind e dhjetë euro e tridhjetë e katër cent).

Gjykatata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë i vlerësojë edhe pretendimet e të paditues/kundër paditëses lidhur me atë së kontrata është lidhur me vullnetin e lirë të palëve dhe se kontrata është ligj për palët, mirepo kjo gjykate nje pretendime të tillë e refuzojë si të pabazuar për shkak së një dispozitë kontraktuese parasheh një detyrim i cili bie në kundërshtim më një normë imperative dhe ajo dispozitë nuk krjon efekte juridik pavarësisht se palët kanë mundur ta lidhin me vullnetin e tyre, po ashtu kontraktimi i një detyrimi të tillë nuk përbën veprim me të cilin palët mund të disponojnë lirisht pasi që është e ndaluar me dispozita perkatese. Po ashtu sipas dispozites se nenit 86 par.1 percaktohet se “ *Në rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgaditur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër*”, ndersa me dispoziten e nenit 87 par.1 është e percaktuar se “ *Dispozitat e paqarta në kontratën pa shpërblim duhet interpretuar në kuptim që dispozita e rendon më pak ditorin, ndërsa të kontrata me shpërblim në kuptim me të cilin realizohet një marrëdhënie e drejtë e prestimeve reciproke*”. Në rastin konkret kontrata është është përpiluar nga ana e të paditurës/kundër paditëses dhe mbi këtë bazë pretendimet e të paditurës/ kundër paditëses janë të pa bazuara.

Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë i vlerësojë edhe pretendimet ankimore e të paditurës/kundër paditëses lidhur me atë gjykata në shkallë të parë pa të drejtë ka refuzuar propozimin për nxjerrjen e provës me superekspertizë financiare nga një institucion i jashtëm, mirëpo kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar një pretendim të tillë pasi që ekspertiza është plotësuar dy herë sipas propozimeve të palës së paditur/ kundër paditëse andaj kjo ekspertizë është e mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e palëve. Andaj gjykata në shkallë të parë refuzimin e një propozimi të tillë e ka bërë duke respektuar parimin e ekonomizimit të procedurës.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditues/kundër paditëses se gjykata në shkallë të parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale sepse ka aplikuar dispozitat e e LMD-së të vjetër 1978, e jo të LMD-së së vitit 2012, Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se një pretendim i tillë është i pabazuar për faktin se në nenin 1058, paragrafi 3 të LMD-së (viti 2012), percaktohet se dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, me numër 29/78, 49/85 dhe 57/89), ku përfshihen Kreu XXXV-nenet 1065 deri 1068 ( “LMD i vjetër”)-mbeten në fuqi dhe do të vazhdojnë

të zbatohen përshtatshëmrisht. Andaj neni 1068, par 3 i LMD-së së vjetër paraqet dispozitë imperative, e cila nuk mund të ndryshohet as me marrveshjen e palëve dhe se bankat gjatë veprimtarisë së tyre kanë për obligim që kushtet e kredisë t'i përcaktojnë në përputhje me këto dispozita.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale- dhomat e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË,**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.842/22, me datë 17.11.2022**

**KRYETARE E KOLEGJIT,**  
**Saranda Bogaj - Sheremeti, d.v.**